



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KUVENDI**

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d dhe 17 shkronja k, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 3 pika 1.3 të Ligjit për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit nr.03/L-164, nenit 4 të Memorandunit të bashkëpunimit të lidhur mes Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Komunës së Podujevës më datë 18 mars 2014, dhe neneve 14, 15.2 shkronja d dhe 19 shkronja k të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-1/298-10, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 31 mars 2017, mori,

### **VENDIM**

#### **PËR PLOTËSIMIN E NJË VENDI TË LIRË NË KOMISIONIN PËR NDARJEN E SHTËPIVE NË PRONËSI TË KOMUNËS NË LAGJEN E DËSHMORËVE NË BALLOC**

##### **Neni 1**

Në kuadër të përbërjes së Komisionit për ndarjen e shtëpive në pronësi të Komunës në Lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc, familjeve banuese në lagjen e cekur, përkatësisht familjeve të Dëshmorëve, Invalidëve të luftës së UÇK – së, viktimave civile, familjeve me anëtar me nevoja të veçanta dhe atyre në asistencë sociale, në vend të;

- Ruzhdi Dema, ish anëtar, tashmë i ndjerë, emërohet,
- znj. Arbresha Bashota, zyrtare për strehim në Shërbimin Civil të Komunës së Podujevës

##### **Neni 2**

Vendimi është pjesë përbërëse e Vendimit për ngritjen e Komisionit për ndarjen e shtëpive në pronësi të Komunës në Lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc, nr. 01-005-32384 të datës 10 prill 2014.

##### **Neni 3**

Vendimi hynë në fuqi pas vlerësimit të ligjshmërisë përkatësisht regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në Web faqen zyrtare të Komunës.

**Nr. 01-060/04-26137/17**  
**Podujevë,**  
**31 mars 2017**

